

## Përmbledhje e kontratës

- Kjo përmbledhje e kontratës përmban elementët kryesorë të kësaj oferte të shërbimit sipas kërkesave të Ligjit 54/2024<sup>1</sup>
- Ky informacion lehtëson krahasimin midis ofertave të shërbimit.
- Informacion i plotë për shërbimin jepet në dokumenta të tjerë.

Shërbimi/shërbimet dhe pajisje fundore

**Shërbimet e Telefonisë fikse, Internet dhe IPTV nëpërmjet rrjetit fiks për segmentin biznes.**  
Referuar shërbimeve të përzgjedhura, pajisjet (modem dhe/ose dekoder) i jepen pajtimtarit në përdorim.

Çmimi

Shpejtësia Internet deri në (shkarkim/ngarkim)	Internet	Tring Baze	Tring e Plote	Tring e Plote +Sport	DGA Fillestar	DGA Familjare	DGA Premium
200/50 Mbps	1,800	2,400	2,700	3,200	2,400	2,700	4,000
500/100 Mbps	2,000	2,600	2,900	3,400	2,600	2,900	4,200
1 Gbps/200 Mbps	2,200	2,800	3,100	3,600	2,800	3,100	4,400
2.5 Gbps/500 Mbps	3,900	4,500	4,800	5,300	4,500	4,800	6,100

\*Tarifat mujore përfshijnë TVSH.

Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarëveshjeve

- Pajtimtari i ri në rrjet do të paguajë tarifen prej 1,500 lekë për instalimin e shërbimit per kontrate me kohezgatje 12 mujore, vlerë e cila faturohet në faturën e parë të shërbimeve fikse. Vlera e instalimit të shërbimit nuk do të jetë e aplikueshme për ndryshime të produkteve të kësaj përmbledhje për pajtimtarët ekzistues të ONE.
- Secila nga paketat e përzgjedhura në këtë Lidhje, përfshin 2,000 minuta të vlefshme brenda rrjetit fiks dhe celular të ONE nëse PSTN do të jetë aktive.

Ankesat mund të paraqiten: nëpërmjet numrave 142 dhe 123 për të gjitha llojet e ankesave, nëpërmjet sporteve të One Albania ku merret deklarim shkresor për ankesën, nëpërmjet postës drejtuar në adresën zyrtare të One Albania, për të gjitha llojet e ankesave me email në adresën [ankesa-zyrtare@one.al](mailto:ankesa-zyrtare@one.al) në përputhje me Udhëzues për Zgjidhjen e Ankesave, publikuar [https://www.one.al/sites/default/documents/files/inline-files/Aneksi%20nr.2%20Udhezues%20per%20zgjidhjen%20e%20ankesave\\_1.pdf](https://www.one.al/sites/default/documents/files/inline-files/Aneksi%20nr.2%20Udhezues%20per%20zgjidhjen%20e%20ankesave_1.pdf).

*Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë dhe/ose Operatori vonon riparimin e defekteve në rrjetin e tij të telekomunikacioneve, tej afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, atëherë ai detyrohet t'i zbrësë nga fatura e muajit në vijim tarifën e pajtimit në proporcion me ditët në mungesë cilësie/vonese riparimi defekti*

Kohëzgjatja, rinovimi dhe përfundimi

- Kohëzgjatja e afatit fillestar 12 muaj dhe 24 Muaj.
- Në cdo kohë pas afatit fillestar 12/24 muaj pajtimtari mund të rinovoj kontratën.
- Për paketat me afat 12 mujor Pajtimtari blen dekoderin. Vlera e dekoderit është 8,000 Lekë.
- Në rast përfundimi të paketës së përzgjedhur përpara afatit fillestar të përzgjedhur, Pajtimtari do të paguajë proporcionalisht tarifën mujore për periudhën e mbetur të paketës. Gjithashtu Pajtimtari duhet ti kthejë pajisjet e marra në përdorim me përfundimin e kontratës. Në rast të kundërt, nëse Pajtimtari nuk i kthen pajisjet, atëherë do të paguajë vlerën e penaliteteve për pajisjet perkatësisht: modem ONT – 6,000 Lekë; dekoder – 5,000 Lekë.

Informacione të tjera të rëndësishme

- Paketat IPTV kanë shërbime të tjera të IPTV të tilla si Menu, Guide, Kod PIN për personalizim dhe kontroll.
- Paketat IPTV me kanale televizive të platformës Tring kanë shërbimin VoD 3 muaj nga momenti i aktivizimit.
- Shërbimi ofohet automatikisht me IP dinamike. IP Statike mund të aktivizohet me kërkesë të vecantë nga klienti pa pagesë.
- Shërbimi akses në internet me shpejtësi 200/50 Mbps është i vlefshëm për 2 TB/muaj. Pas këtij vëllimi, shpejtësia e internetit do të jetë 50 Mbps pa limit.
- Shërbimi akses në internet me shpejtësi 500/100 Mbps është i vlefshëm për 2 TB/muaj. Pas këtij vëllimi, shpejtësia e internetit do të jetë 100 Mbps pa limit.
- Shërbimi akses në internet me shpejtësi 1024/200 Mbps është i vlefshëm për 3 TB/muaj. Pas këtij vëllimi, shpejtësia e internetit do të jetë 100 Mbps pa limit.
- Shërbimi akses në internet me shpejtësi 2.5 Gbps/500 Mbps është i vlefshëm për 3 TB/muaj. Pas këtij vëllimi, shpejtësia e internetit do të jetë 100 Mbps pa limit.

**Ky dokument është publikuar në datë 1 Maj 2026.**

<sup>1</sup> Pika 5 e Nenit 141 të Ligjit 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", e cila është përfunduar plotësisht me Nenin 102 (3) të Direktivës (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, që përcakton Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike (OJ L 321, 17.12.2018, f. 36)